



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 9091 Prot.

Lezhë, më 05 . 05 .2021

VENDIM

Nr. 87 Datë 30 . 04 . 2021

PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E
PREKURA NGA RRËSHQITJET E DHEUT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE
UNGREJ DHE LAGJEN E SPITALIT

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, neni 13 pika 1(i) dhe në VKM 384 datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, shkresave nr.3473 datë 08.03.2021 dhe nr. 3801 date 10.03.2021 të Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe shkresën nr. 141/1 datë 19.02.2021 të Prefektit të Qarkut Lezhë, ku dërgohet studimi gjeologo-inxhinierik si dhe i situatës së krijuar si pasojë e rrëshqitjes së dheut nga reshjet e shumta të shiut në Njësinë Administrative Ungrej dhe në lagjen afër spitalit në qytetin e Lezhës, nevojitet pagesa e qirasë për këto familje, në ligjin nr. 68 , datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.172 datë 27.11.2020, Për miratimin e Buxhetit të vitit 2021, dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023” pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Shërbimit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

I. Miratimin e ndihmës financiare për subvencionimin e qirasë për familjet:

| Nr. | Emër, Atësi, Mbiemër | Nr. anëtarësh | Vlera mujore | Periudha | Totali |
|-----|---------------------------|---------------|--------------|------------------------|----------------|
| 1 | Pashk Dodë Fizi | 1 | 12 600 | 01.02.2021- 31.12.2021 | 138 600 |
| 2 | Pjetër Ndue Fizi | 2 | 12 600 | 01.02.2021 -31.12.2021 | 138 600 |
| 3 | Gjon Preng Fizi | 7 | 20 400 | 01.02.2021 -31.12.2021 | 224 400 |
| 4 | Xhevahir Jaho Molla | 2 | 12 600 | 01.02.2021 -31.12.2021 | 138 600 |
| | Totali për 11 muaj | | | | 640 200 |

- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

